



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION

Në bazë të nenit 41 par. 3 pika 3.4, dhe nenin 42 par. 2 të Ligjit për Avokatinë Nr. 04/L-193 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/31 maj 2013), Kuvendi i Odës së Avokatëve të Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datë 04 nëntor 2017, aprovon,

STATUTIN E ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Statut rregullohen: e drejta për ushtrimin e avokatisë, praktikantët dhe anëtarët vullnetar, regjistrat e Odës së Avokatëve të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Oda), të drejtat dhe detyrat e avokatëve, organizimi i brendshëm i Odës dhe shtrirja regjionale e Odës, përgjegjësia disiplinore e avokatëve dhe e praktikantëve, specializimi i avokatëve, afarizmi financiar, administrata e Odës, çështjet tjera të rëndësishme për rregullimin e avokatisë dhe organizimin e Odës.

Neni 2

Qëllimi i këtij statuti është rregullimi i fitimit dhe humbja e të drejtave në ushtrimin e avokatisë, mbajtjes së regjistrave, të drejtave dhe detyrave të avokatëve, organizimin e Odës, sigurimi i avancimit të avokatisë si shërbim publik i lirë dhe i pavarur dhe sigurimin efikas të ndihmës juridike, sipas bazës dhe në pajtim me Kushtetutën, Ligjin për Avokatinë dhe të ligjeve tjera, të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare, të Statutit, Kodit të etikës profesionale të avokatisë dhe të dispozitave tjera dhe të akteve të përgjithshme.

Neni 3

1. Oda është organizatë e pavarur e avokatëve me autorizime publike, e themeluar me ligj.
2. Emërtimi i plotë i Odës është: ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS. Emërtimi i shkurtë është: OAK
3. Krahas emërtimit në njëerën nga gjuhët zyrtare, Oda mund të shfrytëzohet edhe emërtimin në gjuhën angleze, atëherë emërtimi është: Kosovo Bar Association, ose shkurtimisht: KBA.
4. Për detyrimet e veta Oda përgjigjet me të gjitha mjetet e saja.
5. Mjetet për punën e Odës sigurohen në mënyrën e paraparë me aktet normative ne fuqi.

Neni 4

Oda, në pajtim me Ligjin për Avokatinë, organizon dhe rregullon avokatinë si shërbim të lirë dhe të pavarur.

Neni 5

1. Anëtarësia e Odës përbëhet nga:

1.1 avokatët,

1.2 praktikantët, dhe

1.3 anëtarët vullnetarë.

Neni 6

1.Oda, përveç autorizimeve publike nga neni 41 i Ligjit për avokatinë, kryen edhe këto punë:

1.1 të ruajë pavarësinë e avokatisë dhe të garantojë ushtrimin e lirë dhe të rregullt të veprimtarisë së avokatit,

1.2 t'i mbikëqyrë avokatët, zyrat e përbashkëta, shoqëritë e avokatëve si dhe format e tjera të lidhjeve të avokatëve për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të palëve,

1.3 t'i kushtojë kujdes ngritjes së përhershme profesionale të avokatëve dhe praktikantëve përmes programeve të mentorimit të gjeneratave dhe atyre të arsimimit të vazhdueshëm, dhe

1.4 ta zhvillojë dhe përparojë etikën profesionale dhe të mbikëqyrë respektimin e saj,

1.5 t'i analizojë dhe studiojë dukuritë e rëndësishme për përparimin dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve dhe të personave juridik,

1.6 t'i njoftojë organet kompetente mbi gjendjen dhe të përfshihet në aktivitetet për avancimin e të drejtave të njeriut dhe të qytetarit,

1.7 të kujdeset për kushtet materiale dhe interesat e tjera të avokatëve,

1.8 të kujdeset për statusin, të drejtat e avokatëve dhe të punësuarve në zyrat e tyre,

1.9 të organizojë forma të ndryshme të bashkëpunimit me organet e drejtësisë, organet administrative, me organizatat e profesioneve të tjera të profesionistëve juridik, si dhe me institucionet shkencore, fakultetet juridike dhe organizatat dhe institucionet tjera me programe arsimimi ne drejtësi.

1.10 t'i vë kontaktet për bashkëpunim dhe zhvillim me organizatat, organet, institucionet dhe asociacionet e ndryshme juridike vendore dhe ndërkombëtare.

1.11 të ketë rol proaktiv në procesin legjislativ, në kuptim të shqyrtimit dhe komentimit të legjislacionit.

1.12 vendos për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve vetanake;

1.13 autoritetit ekzekutiv dhe legjislativ i paraqet iniciativa për përparimin e avokaturës, sistemit gjyqësor dhe juridik;

1.14 kryen edhe punë të tjera të parapara me këtë Statut dhe aktet e përgjithshme të nxjerra në bazë të Statutit.

Neni 7

Në procedurën për regjistrimin në regjistrat e avokatëve dhe praktikantëve, për përsëritjen e procedurës së regjistrimit si dhe në rastet e tjera kur vendoset mbi të drejtat dhe detyrimet e avokatëve, praktikantëve dhe shoqërive të avokatëve, nëse me Ligjin për Avokatinë, Statut apo me ndonjë akt tjetër të Odës nuk është përcaktuar ndryshe, zbatohen dispozitat e Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative.

II. E DREJTA PËR USHTRIMIN E AVOKATISË

Neni 8

1. Fitimi i të drejtës për ushtrimin e profesionit të avokatit përcaktohet me ligj.
2. E drejta për regjistrim në regjistrin e avokatëve fitohet me licencim në Odë.

Neni 9

1. Kandidati, i cili ka paraqitur kërkesën për regjistrim në Regjistrin e avokatëve, mund të vijoj Kursin Përgatitor për Avokatë (KPA).
2. KPA, organizohet nga Qendra Trajnuese për Avokat (QTA), dhe paraqet një program të aftësimit elementar profesional, të përcaktuar nga QTA dhe të aprovuar nga Këshilli Drejtues.

Neni 10

1. Kandidati, i cili ka paraqitur kërkesën për regjistrim në Regjistrin e avokatëve, i nënshtrohet provimit të Etikës për avokat para një Komisioni të veçantë, i cili caktohet nga Këshilli Drejtues i Odës.
2. Komisioni nga par.1 i këtij neni vepron në bazë të rregullores së veçantë.

Neni 11

Kandidatët të cilët plotësojnë kushtet për regjistrim pas dhënies së betimit, pajisen me Licencën (LA) dhe Kartelën e Avokatit (KA).

Neni 12

1. Licenca për avokatë (më tej: LA), përmban:
 - 1.1 Republika e Kosovës / Republika Kosova/Republic of Kosova;
 - 1.2 mbishkrimin “Oda e Avokatëve të Kosovës/Advokatska Komora Kosova/ Kosova Bar Association;
 - 1.3 numrin rendor nga Regjistri i avokatëve dhe datën e regjistrimit;
 - 1.4 emrin dhe mbiemrin e avokatit;
 - 1.5 selinë e zyrës së avokatit;
 - 1.6 vendin dhe datën e lëshimit;
 - 1.7 vulën e thatë, në të cilën është i gravuar “neni 111 i Kushtetutës së Kosovës”.
2. Kartela e avokatit (KA), përmban:
 - 2.1 Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosova;
 - 2.2 mbishkrimin “Oda e Avokatëve të Kosovës/Advokatska Komora Kosova/ Kosova Bar Association;
 - 2.3 numrin rendor nga Regjistri i avokatëve;
 - 2.4 emërtimin “Avokat” ose “Advokat”;
 - 2.5 emrin dhe mbiemrin e avokatit;
 - 2.6 selinë e zyrës së avokatit;
 - 2.7 fotografinë e avokatit; dhe
 - 2.8 datën e lëshimit dhe skadimit të kartelës.

Neni 13

Vendimin mbi madhësinë dhe formën e kartelës së avokatit e merr Këshilli Drejtues i Odës.

Neni 14

Nëse për çfarëdo arsye bëhet ndryshimi ose dëmtimi i ndonjë shënimi në Kartelë, avokati është i detyruar që menjëherë të kërkojë kartelë të re.

Neni 15

Me rastin e çregjistrimit apo shlyerjes avokati është i detyruar që në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga pranimi i vendimit të Këshillit Drejtues të Odës, ta kthejë Licencën dhe Kartelën.

Neni 16

Kërkesa për regjistrim në regjistrin e avokatëve i drejtohet Këshillit Drejtues të Odës.

Neni 17

Kërkesës për regjistrim duhet bashkëngjitur dëshmitë mbi plotësimin e kushteve ligjore.

Neni 18

Procedurën deri në marrjen e vendimit e udhëheq Drejtori ekzekutiv i Odës.

Neni 19

1. Kundër vendimit të Këshillit drejtues me të cilin është refuzuar Kërkesa për regjistrim, mund të ushtrohet ankesë siç parashihet me nenin 6 të Ligjit për Avokatinë.

Neni 20

1. Procedura e regjistrimit në Regjistrin e avokatëve e filluar sipas kërkesës ndërpritet nëse vërtetohet se ndaj parashtruesit të kërkesës ka filluar ndonjë procedurë hetimore për vepër penale që e bënë të padenjë për ushtrimin e veprimtarisë së avokatit.
2. Nëse pas regjistrimit të lejuar kuptohet se paraqitësi nuk i ka plotësuar kushtet për fitimin e drejtës së ushtrimit të avokatisë, procedura e regjistrimit do të përsëritet sipas detyrës zyrtare, me kërkesën e Drejtorit ekzekutiv.
3. Për propozimin për përsëritjen e procedurës nga paragrafi 2 i këtij neni vendos Këshilli Drejtues i Odës.

III. PRAKTIKANTËT

Neni 21

E drejta për kryerjen e praktikës në zyrën e avokatisë fitohet me regjistrim në Regjistrin e praktikantëve.

Neni 22

Lidhur me kërkesën për regjistrim në regjistrin e praktikantëve vendos Këshilli Drejtues i Odës.

Neni 23

Kërkesës për regjistrim në regjistrin e praktikantëve i bashkëngjiten dëshmitë mbi plotësimin e kushteve të parapara për regjistrim, nga neni 23 par.1 i Ligjit për Avokatinë.

Neni 24

Avokati është i detyruar ta udhëheqë praktikantin në aftësimin profesional në të gjitha lëmit juridike.

Neni 25

Dispozitat e këtij Statuti dhe të Kodit të Etikës Profesionale të avokatit të cilat i referohen të drejtave dhe detyrimeve të avokatëve, zbatohen edhe për praktikantin.

Neni 26

1. Praktikanti mund ta ndërrojë zyrën e avokatit në të cilën kryen praktikën.
2. Për këtë ndërrim, praktikanti është i obliguar që Odës t'i paraqes kërkesë për ndërrimin e zyrës së avokatit. Lidhur me kërkesë e paraqitur vendos Këshilli Drejtues me propozimin e Drejtorit Ekzekutiv.
3. Kërkesës duhet t'i bashkëngjisë kontratën me avokatin të cili e vazhdon kryerjen e praktikës.

Neni 27

Praktikantit të cilit i është ndërprerë puna për arsye të ndryshme ligjore mund ta fillojë procedurën e re të regjistrimit pasi kanë kaluar arsyet e ndërprerjes.

Neni 28

Vendimin për ndërprerjen e punës së praktikantit në zyrën e avokatit e merr Kryetari i Odës. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankesë Këshillit drejtues të Odës në afatin prej tetë (8) ditësh nga dita e marrjes së vendimit.

Neni 29

1. Kryetari i Odës e pezullon veprimtarinë e praktikantit me vendim të posaçëm, gjersa i njëjti gjendet në paraburgim.
2. Kryetari i Odës mund t'ia ndalojë punën, praktikantit, me vendim të posaçëm, nëse është iniciuar procedurë disiplinore kundër tij, për shkelje të rënda të detyrës dhe prestigjit të avokatisë.

Neni 30

Dispozitat lidhur me regjistrimin, të drejtën në ankesë dhe vendosjen lidhur me ankesën e avokatit, përshtatshmërisht zbatohen edhe kur është fjala për praktikantin.

IV. ANËTARËT VULLNETARË

Neni 31

Statusi i anëtarit vullnetarë, fitohet me regjistrimin në Regjistrin e anëtarëve vullnetarë të Odës.

Neni 32

Procedura e regjistrimit të anëtarëve vullnetarë, të drejtat dhe detyrimet e tyre përcaktohen me akt të veçantë të Këshillit Drejtues të Odës.

V. REGJISTRAT E ODËS

Neni 33

1. Oda i mban këta regjistra:

1.1 Regjistrin e avokatëve;

1.2 Regjistrin e praktikantëve;

1.3 Regjistrin e zyrave të përbashkëta të avokatisë;

1.4 Regjistrin e shoqërive të avokatëve;

1.5 Regjistrin mbi bashkëpunimin ndërmjet zyrave të avokatëve;

1.6 Regjistrin e avokatëve të huaj;

1.7 Regjistrin e anëtarëve vullnetarë;

1.8 Regjistrin e personave që ofrojnë këshilla juridike sipas nenit 10 par. 3 të Ligjit për Avokatinë.

Neni 34

1. Regjistrat nga neni paraprak janë libra të lidhur.
2. Faqet e këtyre librave shënohen me numra rendorë.

Neni 35

Secilin regjistër e vërteton Kryetari i Odës duke e shënuar në pjesën e lartë të faqes së parë, numrin e përgjithshëm të faqeve dhe datën e vërtetimit, nënshkrimin e tij dhe vulën e Odës.

Neni 36

1. Mënyrën e udhëheqjes dhe të plotësimit të regjistrave e përcakton me vendim të posaçëm Këshilli Drejtues i Odës.
2. Regjistrat mund të mbahen edhe në formë elektronike.

Neni 37

1. Në Regjistrin e avokatëve shënohet:

1.1 emri dhe mbiemri i avokatit;

1.2 numri i tij personal;

1.3 data dhe vendi i lindjes;

1.4 data e regjistrimit;

1.5 numri dhe data e vendimit mbi regjistrimin në Odë;

1.6 data e dhënies së betimit solemn;

1.7 selia e zyrës;

1.8 statusi i avokatit në shoqërinë e avokatëve;

1.9 anëtarësia në zyrën e përbashkët;

1.10 numrat dhe datat e vendimeve me të cilat janë themeluar ndryshimet në punën e avokatit;

1.11 data dhe arsyeja e fshirjes së emrit të avokatit nga regjistri së bashku me numrin dhe datën e vendimit;

1.12 emri dhe mbiemri i avokatit, numri dhe data e vendimit;

1.13 shënimi mbi fillimin e procedurës disiplinore së bashku me numrin dhe datën e vendimit;

1.14 shënimet mbi fillimin e procedurës disiplinore së bashku me të gjitha elementet e asaj procedure; dhe

1.15 shënimet mbi anëtarësimin në organet e Odës si dhe kohëzgjatja e tyre.

Neni 38

1. Në regjistrin e praktikantëve shënohet:

1.1 emri dhe mbiemri i praktikantit;

1.2 numri i tij personal;

1.3 data dhe vendi i lindjes;

1.4 data e regjistrimit si dhe numri dhe data e vendimit;

1.5 shënimet mbi zyrën e avokatit ku punon praktikanti;

1.6 kohëzgjatja e stazhit të praktikantit;

1.7 shënimet mbi vendimet për ndryshimet në praktikën e praktikantit;

1.8 data dhe arsyeja e fshirjes së praktikantit nga regjistri së bashku me numrin dhe datën e vendimit; dhe

1.9 shënimet mbi fillimin e përsëritjes së procedurës të regjistrimit, të fillimit të procedurës disiplinore së bashku me numrat dhe datat e vendimeve.

Neni 39

1. Në regjistrin e zyrave të përbashkëta shënohen:

1.1 emri dhe mbiemri i avokatëve;

1.2 numri me të cilin janë evidentuar avokatet në regjistrin e avokatëve;

1.3 numri me të cilin është shënuar zyra e përbashkët në regjistrin e zyrave të përbashkëta të avokatisë; dhe

1.4 data dhe numri i vendimit mbi regjistrimin.

Neni 40

1. Në regjistrin e shoqërive të avokatëve shënohen:

1.1 emërtimi i shoqërisë së avokatëve që duhet të përmbajë mbiemrin e së paku njërit prej anëtarëve të shoqërisë dhe parashtesën apo prapashtesën përkatëse sipas tipit të shoqërisë të themeluar në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare;

1.2 emrat e avokatëve, anëtarë të shoqërisë;

1.3 specializimi i shoqërisë për degë të caktuara të drejtësisë, nëse ka një të tillë;

1.4 adresën e selisë së shoqërisë;

1.5 numrat e telefonave dhe faksit;

1.6 adresën elektronike;

1.7 adresa e ueb faqes, nëse ka të tillë.

Neni 41

Mënyrën e udhëheqjes dhe plotësimit të regjistrit të zyrave të përbashkëta dhe të regjistrit të shoqërive së avokatëve me vendim të posaçëm e përcakton Këshilli Drejtues i Odës.

Neni 42

1. Regjistri për bashkëpunimin e zyrave të avokatëve përmban:

1.1 shënimet për zyrat e avokatëve të cilët e kanë lidhur kontratën;

1.2 vendin dhe datën e lidhjes së kontratës së bashku me shënimet mbi plotësimet dhe ndryshimet e mëvonshme;

1.3 shënimin e shkurtër mbi përmbajtjen dhe formën e bashkëpunimit; dhe

1.4 datën e regjistrimit, datën dhe numrin e vendimit.

Neni 43

1. Në Regjistrin e avokatëve të huaj shënohen të dhënat e njëjta sikurse edhe në regjistrat e avokatëve vendor, si dhe:

1.1 të dhënat lidhur me regjistrimin nga autoriteti përkatës i vendit ku është i licencuar avokati;

1.2 të dhënat lidhur me Provimin e Përputhshmërisë (PP).

Neni 44

1. Në regjistrin e anëtarësisë vullnetare shënohen:

1.1 emri dhe mbiemri i anëtarit vullnetarë,

1.2 numri i tij personal,

1.3 data dhe vendi i lindjes,

1.4 numri dhe data e vendimit për regjistrim.

Neni 45

1. Në regjistrin e personave që ofrojnë këshilla juridike sipas nenit 10 par. 3 të Ligjit për Avokatinë shënohen:

1.1 emri dhe mbiemri i personit që ofron këshillë juridike,

1.2 numri i tij personal,

1.3 data dhe vendi i lindjes,

1.4 shënime për punësimin si profesor ordinar, inordinar i lëndëve juridike në fakultetet e Republikës së Kosovës

1.5 gradat shkencore të fituara,

1.6 shënimet mbi vendimet për ndryshimet në punën e praktikantit

1.7 numri dhe data e vendimit për regjistrim.

VI. KUSHTET, MËNYRA DHE PROCEDURA E USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË AVOKATISË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS NGA ANA E AVOKATËVE NGA SHTETET E TJERA

Neni 46

1. Avokatët nga shtetet e tjera mund të ushtrojnë profesionin e avokatit në territorin e Republikës së Kosovës nën kushtet e përcaktuara me nenin 40 të Ligjit për avokatinë dhe të këtij Statuti.

2. Të drejtë regjistrimi në regjistrin e avokatëve të huaj e ka avokati nga shteti anëtarë i Bashkimit Evropian nëse i plotëson kushtet nga neni 40 i Ligjit për avokatinë, si dhe nëse:

2.1 nuk është i shkarkuar si gjyqtar, prokuror shtetëror, noter ose përmbarues privat; dhe

2.2 e jep provimin e jurisprudencës sipas programit për dhënien e provimit të jurisprudencës i cili është paraparë me Ligj me të cilin është rregulluar dhënia e provimit të jurisprudencës, në gjuhën zyrtare në Republikën e Kosovës.

3. Avokati nga paragrafi 1 i këtij neni regjistrohet në regjistrin e avokatëve të huaj dhe kryen veprimtarinë e avokatisë në Republikën e Kosovës nën emërtimin “avokat” “advokat”.

4. Avokati nga paragrafi 1 i këtij neni kërkesës për regjistrim në regjistrin e avokatëve të huaj, është i detyruar që t’ia bashkangjisë:

4.1 dëshminë për nënshtetësinë e shtetit anëtarë të Bashkimit Evropian;

4.2 dëshminë se ka të drejtë që të ushtrojë veprimtarinë e avokaturës në shtetin anëtarë të Bashkimit Evropian (në tekstin e mëtejme: shteti amë); si dhe

4.3 dëshmitë e tjera për plotësimin e kushteve nga paragrafi 1 i këtij neni.

5. Dokumentet me të cilat dëshmohen faktet nga paragrafi 3 i këtij neni do të merren parasysh nëse nuk kanë kaluar tre (3) muaj nga dita i lëshimit të tyre dhe doemos duhet të dërgohen në përkthim të vërtetuar në njërën nga gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

6. Avokati nga paragrafi 1 i këtij neni i cili është regjistruar në regjistrin e avokatëve të huaj ka të drejtë dhe detyrë që ti kryej punët e ndihmës juridike nga neni 4 i Ligjit për Avokatinë, me të gjitha të drejtat dhe detyrat në ushtrimin e veprimtarisë së avokatisë.

Neni 47

1. Oda, për regjistrimin në regjistrin e avokatëve të huaj, do ta informojë organin kompetent në shtetin amë të avokatit nga neni 46 paragrafi 2 i këtij Statuti.

2. Avokati nga neni 46 par.2 i këtij Statuti është i detyruar që pas nxjerrjes së vendimit për regjistrim në regjistrin e avokatëve të huaj të kryej pagesën e shpenzimeve të parapara për regjistrim dhe të lidhë kontratën për sigurimin ndaj përgjegjësisë profesionale, në pajtim me neni 7 të Ligjit për

Avokatinë.

3. Avokati nga neni 46 paragrafi 2 i këtij Statuti tërësisht ose pjesërisht lirohet nga lidhja e kontratës për sigurimin nga përgjegjësia profesionale nëse në shtetin amë është i siguruar tërësisht ose pjesërisht nga përgjegjësia profesionale.

Neni 48

1. Të drejtë regjistrimi në regjistrin e avokatëve të huaj, me qëllim të ushtrimit të veprimtarisë së avokatisë në Kosovë sipas emërimit me të cilin është regjistruar në shtetin në gjuhën zyrtare ose në një nga gjuhët zyrtare të shtetit amë, e ka avokati nga shteti anëtar i Bashkimit Evropian i cili është regjistruar në regjistrin për ushtrimin e veprimtarisë së avokaturës në shtetin amë, që është shtetas i shtetit anëtare të Bashkimit Evropian dhe i cili është i siguruar nga përgjegjësia profesionale.

2. Avokati nga paragrafi 1 i këtij neni kërkesës për regjistrim në regjistrin e avokatëve të huaj, është i obliguar që t'ia bashkangjisë:

2.1 dëshminë se është i regjistruar në regjistrin për ushtrimin e veprimtarisë së avokatisë në shtetin amë;

2.2 dëshminë se është shtetas i shtetit anëtare të Bashkimit Evropian; dhe

2.3 dëshminë se është i siguruar nga përgjegjësia profesionale.

3. Dokumentet me të cilat dëshmohen faktet nga paragrafi 1 i këtij neni do të merren parasysh nëse nuk kanë kaluar tre (3) muaj nga dita e lëshimit të tyre dhe duhet të jenë të dërguara në përkthim të vërtetuar në një nga gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

4. Avokati i cili është i regjistruar në regjistrin e avokatëve të huaj në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, e kryen veprimtarinë e avokatisë me emërtimin me të cilin është regjistruar në shtetin amë, duke u theksuar organi kompetent tek i cili është regjistruar në shtetin e tij amë.

5. Avokati i cili është regjistruar në regjistrin e avokatëve të huaj në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni veprimtarinë e avokatisë mund ta ushtrojë edhe si shoqëri e avokatëve ose zyre e përbashkët e avokatisë nën emërtimin nga shteti amë, ndërsa mund të shfrytëzojë emërtimin e shoqërisë së avokatisë ose të zyrës së përbashkët të avokatisë anëtare i të cilës është në shtetin amë, për çka është i detyruar që Odës ti dërgojë dëshminë nga shteti amë.

6. Avokati i cili është regjistruar në regjistrin e avokatëve të huaj në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni mund të jep këshilla për të drejtën e shtetit amë, të drejtën e Bashkimit evropian dhe për të drejtën ndërkombëtare.

7. Avokati i cili është regjistruar në regjistrin e avokatëve të huaj në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni punët e përfaqësimit në gjykata dhe organe tjera shtetërore, organeve të administratës shtetërore dhe organeve të vetëqeverisjes lokale duhet ti kryejë së bashku me avokatin i cili në

Republikën e Kosovës ka të drejtë dhe detyrë që të ushtrojë veprimtarinë e avokatisë me emërtim “avokat” “advokat” në gjuhën zyrtare në Republikën e Kosovës.

8. Avokati i cili është i regjistruar në regjistrin e avokatëve të huaj në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni nuk mundet me u zgjedhë në organe të Odës, as të punësojë praktikantin avokat.

Neni 49

1. Avokati i cili është regjistruar në regjistrin e avokatëve të huaj në pajtim me nenin 48 paragrafi 1 të këtij Statuti dhe i cili veprimtarinë e avokatisë e kryen me emërtimin sipas të cilit është regjistruar në shtetin amë së paku tre (3) vjet në Republikën e Kosovës, mund të regjistrohet në regjistrin e avokatëve të huaj si avokat i cili ushtron veprimtarinë e avokatisë me emërtim “avokat” “advokat”.

2. Avokati nga paragrafi 1 i këtij neni, kërkesës për regjistrim në regjistrin e avokatëve të huaj i bashkangjitë dëshminë për veprimin në lëndët në Kosovë në pajtim me nenin 48 paragrafi 6 dhe 7 të këtij Statuti, në periudhën prej më së paku tre (3) vite.

3. Listën e avokatëve të regjistruar në regjistrin e avokatëve të huaj Oda ua dërgon Gjykatave dhe organeve tjera.

Neni 50

1. Punët nga neni 48 paragrafi 6 dhe 7 të këtij Statuti mund ti kryej avokati nga shteti anëtarë i Bashkimit Evropian i cili nuk është i regjistruar në regjistrin e avokatëve të huaj.

2. Për qëllimin e kryerjes së punëve nga paragrafi 1 i këtij neni, avokati nga shteti anëtar i Bashkimit Evropian, është i detyruar që Odës t’i dërgojë lajmërim me shkrim dhe ti bashkëngjisë dëshminë për regjistrimin në regjistrin për kryerjen e veprimtarisë së avokatisë në shtetin amë si dhe dëshminë për sigurimin nga përgjegjësia profesionale në shtetin amë.

3. Avokati nga shteti anëtarë i Bashkimit Evropian është i detyruar që bashkangjitur lajmërimit nga paragrafi 2 i këtij neni Odës t’ia dërgojë të dhënat për adresën e tij ose për të autorizuarin të cilin e ka caktuar për pranim të shkresave në Kosovë.

4. Në bazë të lajmërimit, dëshmime dhe të dhënave nga paragrafi 2 dhe 3 të këtij neni, avokatit nga shteti anëtarë e Bashkimit Evropian, Oda i lëshon vërtetim se mund ti kryejë punët në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 51

Në të drejtat dhe detyrimet të avokatit nga neni 46 dhe 48 të këtij statuti përshtatshëmrisht zbatohen dispozitat e nenit 9 deri në nenin 20 të këtij Statuti.

Neni 52

1. Shoqëritë e avokatëve si formë të kryerjes së veprimtarisë së avokatisë në shtetin anëtarë të Bashkimit Evropian dhe në shtetin anëtarë të Organizatës Botërore të tregtisë në Kosovë mund të themelojnë filialet e tyre në pajtim me marrëveshjen ndërkombëtare dhe me këtë Statut.

2. Filialet nga paragrafi 1 i këtij neni në Kosovë mund të ofrojnë këshilla për të drejtën nga shteti amë, për të drejtën e Bashkimit Evropian dhe nga e drejta ndërkombëtare.

Neni 53

1. Për përgjegjësinë disiplinore, pushimin e përkohshëm dhe ndalimin e marrjes me avokaturë, si dhe për pushimin e drejtave në marrjen me avokatinë e avokatit nga neni 46 par.1 dhe nenit 48 par.1 i këtij Statuti, përshtatshëmrisht zbatohen dispozitat nga neni 53 deri në nenin 66 të Ligjit për Avokatinë.

2. Avokati nga neni 46 par.1 dhe neni 48 par.1 i këtij Statuti ka të drejtë në ndihmë të organit kompetent të shtetit amë në procedurën disiplinore.

3. Masa të ndalimit të marrjes me avokatinë avokatit nga neni 48 par.1 dhe nenit 44c par.1 të këtij Statuti Oda e lajmëron organin kompetent në shtetin amë.

4. Për procedurën e zhvilluar disiplinore dhe për masat e shqiptuara disiplinore avokatëve nga neni 44 par.1 dhe nenit 48 par.1 i këtij Statuti Oda e lajmëron organin kompetent në shtetin amë.

Neni 54

1. Avokati nga neni 50 të këtij Statuti është i obliguar që të respektojë Kodin e Etikës Profesionale.

2. Avokati nga neni 50 të këtij Statuti ka përgjegjësi disiplinore në pajtim me këtë Statut, ndërsa për shkeljen disiplinore të shkaktuar mund ti shqiptohet ndalimi i ushtrimit të avokaturës në Republikën e Kosovës, për çka Oda e informon organin kompetent në shtetin amë.

3. Avokati nga neni 50 të këtij Statuti ka të drejtë në ndihmë nga organi kompetent të shtetit amë në procedurën disiplinore.”

Neni 55

1. Avokatit të huaj Oda mund t'i japë licencë për ushtrimin e profesionit të avokatisë për rast sipas kushteve të veçanta të përcaktuara me këtë Statut, duke autorizuar për dhënie të shërbimeve të avokatisë.

2. Kërkesa për marrjen e licencës për ushtrimin e profesionit të avokatisë për rast në territorin e Republikës së Kosovës i paraqitet Odës, duke ia bashkangjitur:

2.1 marrëveshjen me shkrim si bashkë-avokat duke e përcaktuar lidhjen e propozuar profesionale mes avokatit të vendit dhe atij të huaj e nënshkruar nga të dy avokatët;

2.2 dokumentet mbështetëse për të demonstruar që është i pajisur me Licencë për ushtrimin e profesionit të avokatit në shtetin e origjinës;

2.3 dëshmi nga autoriteti kompetent për regjistrimin e avokatëve sipas së cilit avokatët e Republikës së Kosovës mbi baza të njëjta mund të pajisen me licencë të avokatit në vendin

nga i cili është kërkuesi;

2.4 dëshminë se nuk është i dënuar në procedurën penale që e bëjnë të padenjë për ushtrimin e avokatisë ose nën hetime dhe nuk është i dënuar ose nën hetime në procedurën disiplinore të organit profesional ose drejtues i juridiksionit tjetër; dhe

2.5 ka të paktën pesë (5) vite përvojë si avokat;

2.6 dëshmitë për pagimin e taksës administrative, taksës për dhënien e provimit të përshtatshmërisë, taksës për licencim dhe taksës vjetore për anëtarësi për mbajtje të licencës në pajtim me aktin e nxjerrë nga Këshilli Drejtues.

2.7 dëshminë për kalimin me sukses të Provimit të Përshtatshmërisë pasi që të konstatohet se kërkesa dhe dokumentet përcjellëse janë në rregull në aspektin formal juridik;

3. Dokumentet nga paragrafi 2 nën paragrafët 2.3, 2.4 dhe 2.5 i këtij neni duhet të jenë të vërtetuara nga organi i cili i lëshon dhe të noterizuara.

4. Ligji mbi Avokatinë, Kodi i Etikes, Statuti dhe aktet e tjera të përgjithshme dhe të veçanta të Odës përshtatshmërisht zbatohen edhe për avokatët e huaj të licencuar për rast.

VII. TË DREJTAT DHE DETYRAT E AVOKATËVE

Neni 56

1. Avokati ka të drejtë të zgjedhë dhe të jetë i zgjedhur në organet e Odës.

2. Me akt të veçantë duhet të përcaktohen mekanizma që sigurojnë mundësi për kandidaturën e secilit anëtar për organet e Odës.

3. Akti i këtillë përcakton procedurat kandidaturës dhe zgjedhjes që do të mbështeten në kritere objektive për secilin anëtarë që pretendon zgjedhjen.

Neni 57

Avokatët që zgjidhen në organet e Odës kanë për detyrë të marrin pjesë në aktivitetet e këtyre organeve.

Neni 58

1. Në rast kur, për shkak të sëmundjes apo mungesës, avokati nuk është në gjendje që ta ushtrojë veprimtarinë për me tepër se 6 muaj pandërprerë, është i detyruar ta caktojë zëvendësin nga radhët e avokatëve.

2. Marrëdhëniet e ndërsjella, rregullohen me kontratë të veçantë.

Neni 59

1. Për caktimin e zëvendësit nga neni paraprak, avokati e lajmëron Odën.

2. Nëse avokati nuk e cakton zëvendësin, atëherë Oda i cakton zëvendësin e përkohshëm në zyrën e tij.

Neni 60

Në shoqëritë e avokatëve dhe në zyrat e përbashkëta të avokatëve, avokatin i cili mungon e zëvendësojnë avokatët e tjerë nga shoqëria apo zyra, në mënyrën e përcaktuar me kontratë mbi themelimin e shoqërisë ose të zyrës së përbashkët.

Neni 61

1. Avokati është i detyruar ti përmbush të gjitha obligimet financiare të përcaktuara nga organet dhe aktet normative të Odës .

2. Në rast të mos pagesës të obligimeve nga paragrafi 1 i këtij neni, në afatin e përcaktuar nga Oda, avokatit në mënyrë automatike i humb e drejta e ushtrimit të avokatisë dhe shlyhet nga Regjistri i avokatëve. Vendimin për humbjen e së drejtës së ushtrimit të avokatisë dhe shlyerjes nga Regjistri i avokatëve e nxjerrë Këshilli Drejtues me propozimin e Drejtorit Ekzekutiv.

3. Vendimi për humbjen e së drejtës së ushtrimit të avokatisë dhe shlyerjes nga Regjistri i avokatëve nga par.2 i këtij neni shpallet në ueb-faqen e Odës dhe për këtë vendim informohen institucionet përkatëse.

Neni 62

1. Këshilli Drejtues mund të përcaktojë mekanizma për përkrahje, lehtësira, ose ngarkesa për grupe të caktuara të avokatëve, bazuar në vitet e ushtrimit të profesionit (avokatë të ri, avokatë etj.), moshën (avokate doajenë), specifikave etnike (minoritetet), gjinore (femrat), shtrirjes regjionale (vendet rurale).

2. Instrumente të veçanta të përkrahjes do të ndërtohen për nxitjen e hyrjes në profesion të pjesëtarëve nga grupet specifike të shoqërisë kosovare.

3. Këshilli Drejtues i Odës do të nxisë veçanërisht pjesëmarrjen në aktivitetet e Odës të grupeve të caktuara të interesit, përmes formës së angazhimit vullnetar (shoqata nga lëmi i drejtësisë), pjesë të shoqërisë civile, studentë të drejtësisë etj.

Neni 63

1. Avokati duhet ta ketë vulën e tij. Në vulë shënohet:

1.1 emërtimi “AVOKAT” (në gjuhën shqipe), ose “ADVOKAT” (në gjuhë serbe);

1.2 emri dhe mbiemri i avokatit;

1.3 numri i licencës;

1.4 adresa e zyrës.

2. Çdo shoqëri e avokatëve apo zyre e përbashkët e avokatëve posedon vulën rrethore dhe katrore, në të cilën shënohen këto të dhëna:

2.1 emërtimi i shoqërisë apo zyrës së përbashkët me shkurtesën siç parashihet në Ligjin për Shoqëritë Tregtare;

2.2 adresa e zyrës;

2.3 emërtimi “AVOKAT” (në gjuhën shqipe), ose “ADVOKAT” (në gjuhë serbe);

2.4 numri i licencës.

3. Vula rrethore dhe katrore e avokatit, shoqërisë së avokatëve dhe zyrës së përbashkët të avokatëve ka ngjyrë të kaltër të mbyllët.

4. Vula katrore e avokatit, shoqërisë së avokatëve dhe zyrës së përbashkët të avokatëve të mund të përmbajë edhe titullin akademik, numrin e telefonit, telefaksit, adresën postare, adresën elektronike, ueb faqen.

Neni 64

1. Teksti në vulën e zyrës së avokatit duhet të shkruhet në njërën nga gjuhët zyrtare që janë në përdorim në Kosovë.
2. Teksti në vulën e zyrës së avokatit mund të shkruhet edhe në gjuhën angleze.

Neni 65

1. Pllaka me mbishkrimin e zyrës së avokatit, zyrës së përbashkët dhe shoqërisë së avokatëve duhet të vihet në hyrjen e zyrës.
2. Këshilli Drejtues i Odës me akt të veçantë do të përcakton madhësinë, përmbajtjen, dizajnin dhe formën e pllakës me mbishkrimin e zyrës së avokatit dhe rregullat mbi reklamimin e zyrës së avokatit, zyrës së përbashkët dhe shoqërisë së avokatëve.

Neni 66

Për ndërrimin e selisë së zyrës avokati Odës duhet të paraqes kërkesën, për të cilën vendosë Këshilli Drejtues i Odës sipas propozimit të Drejtorit Ekzekutiv në pajtim me aktin e veçantë për kushtet e zyrës së avokatëve.

VIII. ZËVENDËSI I PËRKOHSHËM ZYRTAR DHE PËRFAQËSUESI I AUTORIZUAR I ZYRËS SË AVOKATISË

Neni 67

1. Nëse avokatit i ndalohet ushtrimi i veprimtarisë sipas Ligjit për Avokatinë dhe në bazë të këtij Statuti, Oda do ta caktojë zëvendësin e përkohshëm nga radhët e avokatëve, mundësisht të atyre ku

është selia e zyrës.

2. Emërimi i zëvendësit të përkohshëm bëhet në të njëjtin vendim me të cilin ndalohet ushtrimi i veprimtarisë.

3. Zëvendësi i përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet që i ka pasur avokati të cilin e zëvendëson edhe pa autorizimin e veçantë të palëve.

Neni 68

1. Zëvendësi i përkohshëm punon në llogari të avokatit të cilin e zëvendëson dhe ka të drejtë në shpërblim për punën e tij në përputhje me Tarifën e avokatëve.

2. Me vendimin me të cilin i kthehet e drejta në punë avokatit, revokohet edhe mandati i zëvendësit të përkohshëm.

Neni 69

Nëse avokatit i ndërpritet e drejta për ushtrimin e veprimtarisë, Këshilli Drejtues i Odës emëron përfaqësuesin e autorizuar të zyrës së tij me të njëjtin vendim me të cilin e vërteton se avokatit i ndërpritet ushtrimi i veprimtarisë.

Neni 70

Përfaqësuesi i autorizuar duhet menjëherë, e më së voni në afatin prej tridhjetë (30) ditësh, t'i lajmërojë palët se avokatit të mëparshëm i është hequr e drejta për ushtrimin e veprimtarisë dhe t'ua kthejë shkresat e lëndëve të tyre.

Neni 71

I autorizuari është i obliguar që, pa ndonjë autorizim të posaçëm, t'i përfaqësojë interesat urgjente të palëve, në mënyrë korrekte, derisa pala nuk e tërheq lëndën ose nuk e tërheq autorizimin.

Neni 73

1. Kur për shkak të vdekjes, pushon ushtrimi i veprimtarisë së avokatit, anëtarët e familjes së ngushtë, kanë të drejtë ta propozojnë përfaqësuesin e autorizuar të zyrës.

2. Këshilli Drejtues i Odës ka për detyrë ta marrë në shqyrtim një propozim të tillë.

Neni 74

1. Pranimi i emërimit si përfaqësues i autorizuar, bëhet në marrëveshje me avokatin.

2. Përfaqësuesi i autorizuar punon në emrin e vet dhe për llogarinë e vet.

Neni 75

1. Përfaqësuesi i autorizuar i kontraktton me ish avokatin ose me pasardhësit e tij, kushtet e mbylljes së zyrës.

2. Nëse kontrata nuk nënshkruhet në afatin e arsyeshëm, ato kushte do t'i përcakton Kryetari i Odës me vendim të posaçëm.

3. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankesë Këshillit Drejtues të Odës në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e marrjes së vendimit.

4. Ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit.

Neni 76

Përfaqësuesi i autorizuar është i obliguar që, pas mbylljes së zyrës, t'ia dorëzojë Odës raportin e punës dhe të mbylljes së zyrës.

IX. ORGANIZIMI I BRENDSHËM I ODËS

Neni 77

1. Organet e Odës janë:

1.1 Konferenca e përgjithshme;

1.2 Kuvendi;

1.3 Kryetari;

1.4 Nënkryetari;

1.4 Këshilli Drejtues;

1.5 Këshilli Mbikëqyrës;

1.6 Organet Disiplinore;

1.7 Komisioni për ankesa.

Neni 78

Mandati i anëtarëve të organeve të Odës zgjat katër (4) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat.

1) Konferenca e Përgjithshme

Neni 79

1. Konferenca e Përgjithshme mblidhet së paku një herë në tri vjet, dhe në të diskutohen çështjet me interes për avokatinë.

2. Konferencën e Përgjithshme e përbëjnë të gjithë avokatët aktiv.

Neni 80

1. Konferenca e Përgjithshme e avokatëve si formë më e gjerë e deklarimit të avokatëve mund të thirret me qëllim të shqyrtimit dhe marrjes së qëndrimeve për çështjet më të rëndësishme të avokatisë. Kuvendi i Odës është i detyruar që të deklarohet pas përfundimit të Konferencës së Përgjithshme.

2. Konferenca si rregull mbahet në vitin e parë pas zgjedhjeve të përfunduara.

3. Konferencën e përgjithshme e thërret kryetari i Odës, ndërsa propozimi i tij për thirrjen e mbledhjes miratohet me shumicën e të gjithë anëtarëve të Këshillit Drejtues të Odës.

4. Kryetari i Odës propozon rendin e ditës dhe cakton kohën dhe vendin e mbajtjes së Konferencës së përgjithshme. Konferencën e Përgjithshme e hap dhe me të udhëheq Kryetari i Odës deri në zgjedhjen e kryesisë së punës prej tre (3) antarëve.

5. Për punën e Konferencës së Përgjithshme mbahet procesverbali i cili duhet të përmbajë edhe të dhënat për numrin e avokatëve.

6. Konferenca e Përgjithshme nxjerr përfundime me shumicën e votave të anëtarëve prezent. Përfundimet e Konferencës së Përgjithshme kanë vlerën e rekomandimeve për organet e tjera të Odës.

2) Kuvendi i Odës

Neni 81

1. Kuvendi e zhvillon aktivitetin e vet në Mbledhje.

2. Mbledhja e rregullt e Kuvendit të Odës (në tekstin e mëtejshëm: Kuvendi), mbahet një herë në vit.

3. Mbledhjen e rregullt të Kuvendit e thërret Kryetari i Odës .

Neni 82

Mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit e thërret Kryetari me nismën e vet, në bazë të kërkesës së 1/3 të delegatëve të Kuvendit, 1/3 e antarëve të Këshillit Drejtues ose në bazë të kërkesës, së paku, të tri Degëve Regjionale të Odës.

Neni 83

1. Delegatët e Kuvendit, Degët regjionale të Odës, të cilët kërkojnë mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit, kërkesën me shkrim duhet t'ia dorëzojnë Kryetarit me propozimin e rendit të ditës.

2. Kryetari e thërret mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Odës, më së voni, në afatin prej dy

(2) muajsh nga dita e marrjes së kërkesës nga par.1 i këtij neni.

Neni 84

1. Thirrja për mbledhjen e rregullt ose të jashtëzakonshme të Kuvendit, si dhe të gjitha materialet përcjellëse, duhet t'i dërgohen secilit antarë, më së voni, pesëmbëdhjetë (15) ditë para mbajtjes së saj.
2. Në thirrje duhet të ceket vendi dhe koha e mbajtjes së Kuvendit.

Neni 85

1. Mbledhja e Kuvendit mund të mbahet dhe të merren vendimet e plotfuqishme nëse në mbledhje merr pjesë shumica e delegatëve.
2. Kuvendi merr vendime me shumicë të thjeshtë votash të delegatëve të pranishëm në mbledhje.

Neni 86

1. Mbledhja e Kuvendit mund t'i zhvillon punimet në sesione dhe seancën plenare. Vendimet e Kuvendit merren në seancën plenare.
2. Me rregulloren për punën e Kuvendit mund të parashihen sesionet disa ditore të Mbledhjes së Kuvendit.

Neni 87

1. Kompetencat e Kuvendit janë:

1.1 Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkyetarit;

1.2 Zgjedhja e Komisioneve Disiplinore;

1.3 Zgjedhja e Komisionit Mbikëqyrës;

1.4 Miratimi i Kodit të Etikës Profesionale, Statutit të Odës së Avokatëve, Tarifës për kompensimin e Avokatëve, Rregullores disiplinore, Rregullores për punën e Kuvendit dhe Rregullores për Arsimimin e Vazhdueshëm Ligjor të Obligueshëm të avokatëve;

1.5 Miratimi i buxhetit të Odës;

1.6 Miratimi i raportit vjetor;

1.7 Vendime mbi çështjet e tjera, të rezervuara me Statutin e Odës së Avokatëve;

1.8 Shqyrtimi i të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me kryerjen e veprimtarisë së avokatisë dhe pozitën e avokatisë;

1.9 Shqyrtimi i raportit të organit mbikëqyrës;

1.10 Debati dhe nxjerrja e qëndrimeve dhe vendimeve lidhur me përparimin e punës së Odës, bashkëpunimin dhe anëtarësinë me institucione dhe asociacione tjera vendore dhe ndërkombëtare;

1.11 Shqyrtimi dhe marrja e qëndrimeve mbi të gjitha çështjet nga fushëveprimi i organeve të tjera të Odës.

Neni 88

Punimet e Kuvendit zhvillohen sipas Rregullores së punës të Kuvendit.

3) Kryetari i Odës

Neni 89

1. Kompetencat e Kryetarit të Odës janë:

1.1 drejton dhe udhëheq Odën;

1.2 përfaqëson Odën;

1.3 udhëheq procedurën e dhënies së betimit solemn;

1.4 i lejon pagesat nga arka e Odës deri në limitin e caktuar nga Këshilli Drejtues dhe vendos për shpenzimin e tyre;

1.5 mbikëqyrë punën e Drejtorit Ekzekutiv të Odës;

1.6 kryen punë të tjera në pajtim me Ligjin për Avokatinë, këtë Statut dhe aktet tjera normative, duke ndërlidhë aktivitetet ditore të Odës ashtu siç është e përcaktuar me ligj.

Neni 90

Për punën e vet Kryetari i përgjigjet Kuvendit të Odës.

Neni 91

1.1 Kryetari, që për shkaqe objektive nuk mund ta ushtrojë detyrën për një kohë të caktuar, e zëvendëson Nënkryetari, ndërsa në mungesën e Kryetarit dhe të Nënkryetarit të Odës, i zëvendëson anëtari i Këshillit Drejtues të cilin e cakton Këshilli Drejtues.

1.2 Nënkryetari nuk mund ta ushtroj detyrën e Kryetarit për një periudhë më të gjatë se 6 muaj.

2. Nënkryetari i Odës përveç punëve nga paragrafi 1 i këtij neni e ndihmon në punë Kryetarin e Odës dhe kryen edhe punë të tjera që Kryetari dhe Këshilli Drejtues i'a besojnë.

3. Të gjitha punët e Odës të cilat, sipas Statutit ose akteve tjetër të përgjithshme, nuk janë në

kompetencë të Kuvendit apo organi tjetër të Odës, i kryen Këshilli Drejtues.

4. Aktet e Këshillit Drejtues të Odës janë përfundimtar. Kundër akteve përfundimtare të Këshillit Drejtues të Odës mund të zhvillohet konflikt administrativ, siç është përcaktuar me ligj.

5. Të gjitha aktet e Odës i nënshkruan Kryetari i Odës. Në rast pengese të Kryetarit, aktet në emër të Odës i nënshkruan Nënkryetari i Odës, ndërsa kur Kryetari dhe Nënkryetari i Odës pengohen, aktet në emër të Odës i nënshkruan anëtari i Këshillit Drejtues të cilin për atë e ka autorizuar Këshilli Drejtues.

6. Dispozita e paragrafit 5 të këtij neni zbatohet edhe për nënshkrimin e akteve të Këshillit Drejtues të Odës.

Neni 92

1. Kryetari dhe Nënkryetari në rastet kur e zëvendëson atë, për punën e vet ka të drejtë në shpërblim.

2. Lartësia e shpërblimit nga par.1 i këtij neni caktohet nga Këshilli Drejtues i Odës.

Neni 93

1. Mandati i Kryetarit dhe Nënkryetarit pushon;

1.1 me dorëheqje;

1.2 me shkarkim;

1.3 kur me tepër se 6 muaj pandërprerë nuk është në gjendje ta ushtroj detyrën.

2. Për procedurën e shkarkimit zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e këtij Statuti lidhur me thirrjen dhe vendimarrjen në mbledhjet e Kuvendit.

4) Këshilli Drejtues i Odës

Neni 94

Këshilli Drejtues i Odës, përbëhet nga Kryetari i Odës, Kryetari i mëparshëm i Odës, Nënkryetari, shtatë (7) anëtarë - Kryetar të Degëve Regjionale si dhe një (1) anëtar jashtë Odës, personi që është i shquar në lëminë juridike, i cili emërohet nga Kuvendi.

Neni 95

1. Kompetencat e Këshillit Drejtues janë:

1.1 përcakton propozimin e akteve normative në kompetencë të Kuvendit për miratim, sipas nenit 75 të Statutit të Odës ;

1.2 miraton akte normative përveç atyre të parashikuara me nën paragrafin 1.1 të këtij neni;

1.2 vendos për lartësinë e shumës për regjistrim, lartësinë e anëtarësisë dhe lartësinë e

shumës së të hollave për obligimet tjera të avokatëve, praktikantëve dhe anëtarëve vullnetarë;

1.4 vendos për shumën e të hollave me të cilat mund të disponojë Këshilli Drejtues i Odës dhe Kryetari i Odës ;

1.5 vendos për programin dhe rekomandimet për ngritjen profesionale të avokatëve dhe praktikanteve;

1.6 vendos dhe jep rekomandime dhe propozime të interesit të përgjithshëm për ushtrimin e avokatisë;

1.7 përcakton propozimin e buxhetit, llogarisë dhe bilancit të Odës dhe ia paraqet Kuvendit për miratim;

1.8 udhëheq afarizmin financiar të Odës;

1.9 përcakton propozimin e raportit mbi punën e Këshillit Drejtues të Odës dhe të Kryetarit të Odës ,

1.10 përgatit raportet për anëtarësimin e Odës në shoqata ndërkombëtare të avokatëve dhe organizatat e tjera dhe i cakton përfaqësuesit e Odës në ato asociacione;

1.11 kujdeset për përparimin e bashkëpunimit të Odës në vendet e tjera dhe me asociacione të tjera profesionale;

1.12 përcjell punën e avokatëve, zyrave të përbashkëta, shoqërive të avokatëve dhe praktikanteve si dhe ndërmerr veprime për përparimin e punës së tyre;

1.13 kryen punë me rëndësi të përgjithshme të Odës;

1.14 organizon takime pune, tryeza të rrumbullakëta etj;

1.15 mbikëqyrë publikimin e Buletinit të Odës dhe botimeve tjera;

1.16 kryen të gjitha punët e përcaktuara me Ligjin për Avokatinë, me këtë Statut dhe akte të tjera të përgjithshme;

1.17 këshillon dhe njofton anëtarët e Odës për çështjet e detyrimeve profesionale;

1.18 vendosë për kërkesat e anëtarësisë në Odën dhe ankesat kundër saj;

1.19 ndërmjetëson në mospajtimet ndërmjet anëtarëve të Odës ;

1.20 mbikëqyrë përmbushjen e detyrimeve që i takojnë anëtarëve të Odës dhe përmbaron vendimet e Komisionit Disiplinor;

1.21 kërkon fillimin e procedurës disiplinore, në qoftë se kjo procedurë nuk është iniciuar nga palët e autorizuara;

1.22 administron me buxhetin e Odës;

1.23 jep llogari vjetore Kuvendit të Odës për administrimin e Odës ;

1.24 përgatit ekspertiza, të kërkuara nga organet zyrtare ose ndonjë gjykatë;

1.25 kontribuon në shkollimin dhe testimin e studentëve dhe praktikantëve;

1.26 bën propozimin për anëtarin e komisionit për provim të jurisprudencës;

1.27 përgatit raportin vjetor Kuvendit të Kosovës, për punën e Odës;

1.28 kryen detyrat e ngarkuara nga Kuvendi i Odës të parashikuara me Statutin e Odës.

Neni 96

1. Mbledhja e Këshillit Drejtues të Odës mund të mbahet dhe të merren vendimet e plotfuqishme nëse në mbledhje merr pjesë shumica e anëtarëve.
2. Këshilli Drejtues të Odës merr vendime me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm.
3. Në mungesë të Kryetarit mbledhjet i udhëheq Nënkryetari.

Neni 97

Kryetari i Odës e thërret mbledhjen e jashtëzakonshme të Këshillit Drejtues të Odës, nëse këtë e kërkon, së paku, 1/3 e anëtarëve të tij.

Neni 98

1. Thirrjet dhe materialet për mbledhjet e Këshillit Drejtues të Odës u dorëzohen anëtarëve, më së voni 8 ditë para mbledhjes.
2. Në thirrje duhet të shënohet vendi dhe koha e mbajtjes së mbledhjes dhe rendi i ditës.

Neni 99

Në mbledhje mbahet procesverbali të cilin e nënshkruajnë Kryesuesi i mbledhjes dhe procesmbajtësi.

5) Këshilli mbikëqyrës

Neni 100

1. Anëtarët e Këshillit mbikëqyrës emërohen nga Kuvendi i Odës.

2. Këshilli mbikëqyrës përbehet nga 5 anëtarë. Kryetari i Këshillit mbikëqyrës zgjidhet nga vetë anëtarët e Këshillit.

Neni 101

1. Sipas propozimit të Këshillit Drejtues të Odës apo 1/3 e anëtarëve të Kuvendit, Kuvendi ka të drejtë ta shkarkojë secilin anëtar të Këshillit mbikëqyrës, edhe para skadimit të mandatit, nëse vërtetohet se nuk e ka kryer detyrën në mënyrë korrekte dhe profesionale.

2. Vendimi i Kuvendit është përfundimtar.

Neni 102

1. Këshilli mbikëqyrës është i obliguar që së paku 1 (një) herë në vit ta kontrollojë afarizmin financiar të Odës.

2. Mbi punën e kryer, Këshilli mbikëqyrës e përpilon raportin të cilin ia dorëzon Kuvendit të Odës për miratim.

Neni 103

Organet e Odës që e udhëheqin afarizmin financiar të Odës (Këshilli Drejtues dhe Kryetari i Odës), janë të obliguar t'i prezantojnë të gjitha shënimet Këshillit mbikëqyrës, të cilat ata i kërkojnë.

6) Organet Disiplinore

Neni 104

1. Procedura disiplinore zhvillohet nga organet disiplinore të Odës.

2. Organet disiplinore përbëhen nga:

2.1 Zyra e Prokurorit Disiplinor;

2.2 Komisioni Disiplinor;

2.3 Komisioni për Ankesa.

3. Veprimet e organeve disiplinore rregullohen me akt të veçantë.

Neni 105

1. Zyra e Prokurorit Disiplinor inicicion, pranon dhe shqyrton çdo fletëparaqitje ndaj avokatëve dhe praktikantëve.

2. Prokurori Disiplinor zgjidhet nga Këshilli Drejtues.

3. Gjatë punës, Zyra e Prokurorit Disiplinor është e pavarur në zhvillimin e procedurës së hetimit sipas Ligjit për Avokatinë, Statutit të Odës, Kodit të Etikës profesionale të Avokatëve dhe Rregullores

Disiplinore të Odës.

4. Përbërja e Zyrës së Prokurorit Disiplinor dhe procedura e përzgjedhjes përcaktohen me akt të veçantë.

5. Zyra e Prokurorit disiplinor sipas fletëparaqitjes së paraqitur do të kryej veprimet hetimore të nevojshme dhe pas kësaj:

5.1 me vendim do ta hudhë poshtë fletëparaqitjen, nëse konkludon se veprimet e paraqitura nuk kanë elemente të shkeljes disiplinore ose për shkak të paraqitjes së parashkrimit të shkeljes dhe të zhvillimit të procedurës disiplinore, ose

5.2 do të përpilojë Propozimin për zhvillimin e procedurës disiplinore për shkeljen disiplinore dhe të njëjtën e përfaqëson deri në përfundimin e procedurës disiplinore.

5.3 Kundër vendimit për hudhje poshtë të fletëparaqitjes disiplinore paraqitësi i fletëparaqitjes ka të drejtë kundërshtimi, nëpërmjet Prokurorit Disiplinor të Odës, në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e pranimit të vendimit, për të cilën vendos Këshilli Drejtues i Odës.

Neni 106

Komisioni disiplinor përbëhet nga dhjetë (10) anëtarë të cilët zgjidhen nga Kuvendi i Odës.

Neni 107

Komisionet disiplinore zgjedhin nga radhët e veta Kryetarin e Komisionit që udhëheq punën e Komisionit.

Neni 108

1. Gjatë punës, anëtarët e komisionit disiplinor janë të pavarur dhe vendosin sipas Ligjit, Statutit të Odës, Kodit të Etikës profesionale të Avokatëve, Rregullores Disiplinore dhe akteve tjera normative të Odës.
2. Sipas propozimit të Këshillit Drejtues apo 1/3 e anëtarëve të Kuvendit, Kuvendi ka të drejtë ta shkarkojë secilin anëtar të Komisionit Disiplinor, edhe para skadimit të mandatit, nëse vërtetohet se nuk e ka kryer detyrën në mënyrë korrekte dhe profesionale.
3. Vendimi i Kuvendit është përfundimtar.

7) Komisioni për ankesa

Neni 109

1. Anëtarët e Komisionit për ankesa emërohen nga Kuvendi i Odës.
2. Komisioni përbëhet prej dhjetë (10) anëtarësh.

3. Kryetari i Komisionit për ankesa zgjidhet nga vetë anëtarët e Komisionit.

Neni 110

1. Komisioni për ankesa, në cilësinë e organit të shkallës së dytë, vendos lidhur me ankesat që parashtrihen kundër vendimeve të Komisionit Disiplinor si dhe rasteve të parapra me nenin 6 dhe 48 të Ligjit për Avokatinë.

2. Kur Komisioni për ankesa vendos sipas ankesave disiplinore është i detyruar që t'i përmbahet rregullave të veçanta të kësaj procedure.

3. Sipas propozimit të Këshillit Drejtues të Odës apo 1/3 e anëtarëve të Kuvendit, Kuvendi ka të drejtë ta shkarkojë secilin anëtar të Komisionit për Ankesa, edhe para skadimit të mandatit, nëse vërtetohet se nuk e ka kryer detyrën në mënyrë korrekte dhe profesionale.

4. Vendimi i Kuvendit është përfundimtar.

Neni 111

1. Komisioni për Ankesa është i obliguar që për ankesat të vendosë në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e parashtrimit të ankesës.

2. Kundër vendimit të Komisionit për ankesa mund të fillohet kontesti administrativ në përputhje me nenin 55 të Ligjit për Avokatinë.

Neni 112

Komisioni për Ankesa punon dhe merr vendime të plotfuqishme në kolegje disiplinore të përcaktuar në Rregulloren për procedurën disiplinore.

X. SHTRIRJA REGJIONALE E ODËS

Neni 113

1. Dega Regjionale është formë e drejtpërdrejtë e vendosjes dhe e realizimit të drejtave dhe detyrave të avokatëve ë cilën e përbëjnë të gjithë avokatët e asaj dege.

2. Degat Regjionale e Odës:

2.1 zgjedhë kryetarin, nënkryetarin, sekretarin dhe delegatët për Kuvendin e Odës dhe të anëtarëve të organeve tjera të Odës;

2.2 jep mendim për të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë themelore të avokatëve dhe të avokatëve praktikantë;

2.3 jep propozime për regjistrim të avokatëve në Regjistrin e avokatëve të Odës;

2.4 diskuton për të gjitha çështjet e punës së avokatëve dhe të avokatëve praktikant në

territorin e saj, në pajtim me dispozitat e këtij Statuti dhe organeve kompetente të Odës i propozon zgjidhjen e tyre;

2.5 diskuton për ruajtjen e nderit dhe të etikës profesionale të avokatëve;

2.6 kujdeset për kushtet e punës së avokatëve dhe të avokatëve praktikant në territorin e vet;

2.7 zbaton vendimet e organeve të Odës;

2.8 me rastin e bastisjes së zyrës së avokatit sipas urdhërit të gjykatës kompetente, siguron prezencën e përfaqësuesit të Odës;

2.9 Këshillit Drejtues të Odës i paraqet raportin e punës;

2.10 zbaton edhe detyrime tjera në pajtim me ligjin dhe aktet e përgjithshme të Odës.

Neni 114

Anëtarë të Degëve Regjionale janë të gjithë avokatët, të cilët selinë e zyrave e kanë në atë regjion.

Neni 115

Dega Regjionale ka Kryetarin, Nënkryetarin dhe Sekretarin.

Neni 116

Organizimi i Degëve Regjionale, detyrat dhe aktivitetet e tyre rregullohen me akt të veçantë.

XI. PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE E AVOKATËVE DHE E PRAKTIKANTËVE

1) Llojet e shkeljeve dhe masave disiplinore

Neni 117

Për shkeljet e detyrave dhe të autoritetit të avokatisë, avokatët dhe praktikantët përgjigjen në bazë të dispozitave ligjore, Statutit të Odës dhe Kodit të Etikës Profesionale të Avokatëve.

Neni 118

1. Shkelja e rëndë e detyrave dhe e autoritetit të avokatisë ekziston:

1.1 nëse pas regjistrimit konstatohet se avokati, në momentin e regjistrimit, nuk i ka plotësuar kushtet ligjore të parapara për regjistrim;

1.2 në rastet kur avokati shpallet fajtor me aktgjykim të formës së prerë për një çështje penale, e cila e vë në dyshim dinjitetin e tij për ushtrimin e mëtejshëm të veprimtarisë së avokatit;

- 1.3 nëse e ushtron punën e avokatit në mënyrë të pandërgjegjshme;
- 1.4 nëse në mënyrë të pandërgjegjshme i kryen punët në rastet e përfaqësimit të autorizuar të zyrës së avokatit tjetër;
- 1.5 nëse e shkel obligimin e ruajtjes së sekretit të avokatisë, përveç rasteve të parashikuara me Kapitullin II të Kodit të Etikës Profesionale për Avokatë;
- 1.6 nëse merr shpërblim më të madh se sa është përcaktuar me tarifë apo me marrëveshje të lirë;
- 1.7 nëse në mënyrë të pandërgjegjshme e udhëheq afarizmin e palës si dhe tenton të mos paguajë ose nuk i'a paguan paratë që i ka marrë për llogarinë e tij;
- 1.8 nëse në ankandin publik, në kundërshtim me interesin e palës që e përfaqëson, ia mundëson vetës, të afërme ose personave të tretë blerjen e lëndës së ankandit;
- 1.9 nëse i shkel rëndë obligimet ndaj praktikantit që punon tek ai;
- 1.10 nëse kërkon klientët në mënyrë të padenjë, përmes personit të tretë dhe në mënyra të tjera;
- 1.11 nëse kërkon shpërblim nga pala kinse në llogari të gjyqtarit, prokurorit apo ndonjë organi tjetër gjyqësor, apo personelit në administratën shtetërore;
- 1.12 nëse në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe të këtij Statuti mban zyrë tjetër jashtë selisë së zyrës së vet ose nëse themelon marrëdhënie të rregullt pune jashtë avokatisë;
- 1.13 nëse, në çfarëdo mënyre e keqpërdor besimin dhe autorizimin e palës që e përfaqëson;
- 1.14 nëse nuk i përmbush obligimet materiale ndaj Odës që rrjedhin nga anëtarësia në Odën e Avokatëve;
- 1.15 Nëse nuk përmbush vendimet e organeve të Odës;
- 1.16 nëse në mënyrë të pandërgjegjshme punon dhe i shkel obligimet në organet e Odës;
- 1.17 nëse pas kërkesës me shkrim nuk i'a dorëzon palës shkresat e lëndës;
- 1.18 nëse e ndërron selinë e zyrës në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe të këtij Statuti ose nuk e njofton Odës për ndërrimin e selisë së zyrës.

Neni 119

Si shkelje e rëndë e detyrave dhe e autoritetit të avokatisë konsiderohet edhe sjellja dhe veprimet e avokatit në jetën private dhe opinionin publik, nëse me ato veprime dhe sjellje cenohet autoriteti i

avokatisë.

Neni 120

1. Përpos shkeljeve nga neni118, shkelja e rëndë e detyrave dhe e autoritetit të avokatisë, në punën e praktikantit ekziston:

1.1 nëse nuk e ushtron praktikën në zyrën e avokatit;

1.2 nëse i shkel rëndë obligimet e veta ligjore ndaj avokatit tek i cili është duke e kryer stazhin e praktikantit; dhe

1.3 nëse punët e avokatisë i kryen në mënyrë të pavarur dhe për llogarinë e vet.

Neni 121

Shkeljet e lehta të detyrës dhe të autoritetit të avokatisë janë, po ashtu, shkeljet nga neni 118 të këtij Statuti, por kur mungon pasoja e rëndë si dhe rastet e tjera të mosrespektimit të dispozitave të Kodit të Etikës profesionale të Avokatëve.

Neni 122

Për shkeljet e kryera mund të shqiptohen masat disiplinore të përcaktuara në nenin 51 të Ligjit për Avokatinë.

Neni 123

1. Gjoba shqiptohet për shkelje të rënda ose me rastin e përsëritjes së shkeljeve të lehta.

2. Lartësia e gjobës mund të jetë deri në €5.000.

3. Për shkeljet e rënda minimumi i gjobës mund të jetë prej €500.

4. Për shkeljet e lehta minimumi i gjobës mund të jetë prej €200.

5. Gjoba arkëtohet në buxhetin e Odës.

Neni 124

1. Ndaj avokatit mund të shqiptohet masa e suspendimit të përkohshëm në rastet kur gjykata pas shqyrtimit të dytë të aktakuzës cakton shqyrtimin kryesor në një lëndë penale, e cila e bën të padenjë për ushtrimin e mëtejshëm të veprimtarisë së avokatit.

1.2 Masën nga par. 1 i këtij neni e shqipton Këshilli Drejtues, me propozimin e Zyrës së Prokurorit Disiplinor.

1.3 Avokatit të suspenduar i ndalohet e drejta për ushtrimin e profesionit, deri në përfundimin e procedurës penale në formën e prerë.

1.4 Avokati i suspenduar ka të drejtë gjatë kohëzgjatjes së suspendimit, të kërkojë nga Këshilli Drejtues i Odës të rishqyrtojë masën nga par. 1 i këtij neni, nëse me aktgjykim të shkallës së parë është shpallur jo fajtor për veprën penale e cila e bën të padenjë për ushtrimin e mëtejshëm të veprimtarisë së avokatit.

1.5 Në vendimin për suspendim Këshilli Drejtues i Odës duhet të veproj në përputhje me nenin 17 të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 125

1. Forma e publikimit të ndëshkimeve disiplinore përcaktohet me akt te veçantë.
2. Për çfarëdo forme të suspendimit ose ndalimit të përkohshëm të së drejtës në ushtrimin e avokatisë, njoftohen të gjitha institucionet relevante.

2) Procedura disiplinore

Neni 126

Procedura disiplinore e Odës rregullohet me akt të veçantë.

3) Parashkrimi

Neni 127

Parashkrimi për fillimin e procedurës dhe ekzekutimin e masave parashihet si në nenin 56 të Ligjit për Avokatinë.

XII. BIBLIOTEKA E ODËS

Neni 128

1. Odës disponon me bibliotekën e vet.
2. Të drejtën e shfrytëzimit të bibliotekës e kanë të gjithë avokatët dhe praktikantët, të regjistruar në regjistrat përkatës pranë Odës.
3. Nën kushtet e caktuara biblioteka e Odës mund të shfrytëzohet edhe nga grupet që merren me studimet në drejtësi dhe qytetaret e tjerë.

Neni 129

1. Këshilli Drejtues i Odës e përcakton pagesën në emër të anëtarësisë për ata avokatë ose praktikantë që dëshirojnë ta shfrytëzojnë bibliotekën.
2. Shuma e mbledhur e mjeteve përdoret vetëm për pasurimin e fondit të bibliotekës dhe për mirëmbajtjen e saj.

Neni 130

Për bibliotekën kujdeset bibliotekisti, i cili e mban evidencën e titujve, të shfrytëzuesve dhe e arkëton pagesën e anëtarësisë.

Neni 131

1. Përpos anëtarësisë, financimi dhe pasurimi i fondit të bibliotekës bëhet edhe në mënyra të tjera.
2. Vendimin mbi këtë e merr Kryetari i Odës.

XIII. SPECIALIZIMI I AVOKATËVE

Neni 132

Avokati që plotëson kushtet ligjore, kushtet nga ky Statut dhe kushtet nga aktet e veçanta të Odës, ka të drejtë ta paraqesë kërkesën për t'iu pranuar titulli i specialistit në degën e caktuar të drejtësisë.

Neni 133

1. Titulli i specialistit pranohet nga këto degë:

- 1.1 E drejta kushtetuese;
- 1.2 E drejta penale;
- 1.3 E drejta civile;
- 1.4 E drejta administrative;
- 1.5 E drejta e punës;
- 1.6 E drejta komerciale;
- 1.7 E drejta bankare;
- 1.8 E drejta e autorit, pronësia intelektuale;
- 1.9 E drejta ndërkombëtare;
- 1.10 Drejtësia për te mitur.

Neni 134

Kërkesa për pranimin e titullit të specialistit i drejtohet Këshillit Drejtues të Odës.

Neni 135

Kushtet dhe procedurën për specializim e përcakton Këshilli Drejtues i Odës me akt të veçantë.

XIV. PUBLIKIMI I BULETINIT

Neni 136

1. Oda nxjerr buletin, si revistë e shkrimit juridik.
2. Buletini publikohet së paku çdo gjashtë (6) muaj.

Neni 137

Anëtarët e redaksisë, redaktorin dhe kryeredaktorin e Buletinit e emëron Këshilli Drejtues i Odës.

Neni 138

Anëtarët e redaksisë i përgjigjen për punën e vet Këshillit Drejtues të Odës, i cili ka të drejtë ta shkarkojë secilin anëtar edhe para skadimit të mandatit.

Neni 139

1. Oda boton edhe publikime të tjera me qëllim të informimit të anëtarësisë për aktivitetet e organeve.
2. Përveç kësaj, Oda boton edhe publikime të veçanta.

XV. MIRËNJOHJET

Neni 140

1. "Dita e Avokatisë së Kosovës" është data 27 dhjetor, si ditë e aprovimit të Ligjit të parë për Avokatinë në Kosovë me emërtimin e mëhershëm "Ligji mbi Avokatinë dhe ndihmën tjetër juridike", Fletorja Zyrtare e KSAK nr.43/1973.
2. Programin e festimit të "Ditës së Avokatisë së Kosovës" e përcakton Këshilli Drejtues i Odës.
3. Në shenjë të mirënjohjes, avokatëve, për rezultatet e veçanta të arritura në ushtrimin e avokatisë, për zhvillimin e saj, si dhe atyre jashtë avokatisë të cilët me kontributin e tyre personal kanë ndihmuar në zhvillimin dhe përparimin e avokatisë ndahet "Plaketa e artë e Odës së Avokatëve të Kosovës për veprën jetësore" dhe "Plaketa e Odës së Avokatëve të Kosovës".
4. Përveç mirënjohjeve nga paragrafi 3 i këtij neni avokatit mund t'i ndahet edhe "Dekorata e Odës së Avokatëve të Kosovës" për punën shumë vjeçare të dalluar në avokati, në organet e Odës së Avokatëve të Kosovës dhe për kryerjen e suksesshme të punëve tjera shoqërore në kuadër të avokatisë, të shoqatave dhe organizatave profesionale.
5. Me rregulloren të cilën e nxjerrë Këshilli Drejtues i Odës përcakton kushtet për ndarjen e mirënjohjeve nga paragrafi 3 dhe 4 i këtij neni.

XVI. AFARIZMI FINANCIAR

Neni 141

1. Afarizmi financiar i Odës zhvillohet sipas para-llogarisë vjetore mbi të hyrat dhe shpenzimet, të cilën e miraton Kuvendi.

2. Afarizmi financiar dhe procedurat të cilat ndërlidhën me to rregullohen me Rregulloren financiare të *Odës*.

Neni 142

1. Të hyrat e rregullta vjetore të Odës janë:

1.1 Të hyrat nga regjistrimi i avokatëve;

1.2 të hyrat nga anëtarësia e avokatëve;

1.3 të hyrat nga pulla e Odës; dhe

1.4 të hyrat nga donacionet, dhuratat, e tjera.

Neni 143

1. Përveç të hyrave të rregullta, Odës disponon edhe me të hyra të jashtëzakonshme:

1.1 pagesa e gjobave nga procedurat disiplinore apo procedurat tjerat; dhe

1.2 të hyrat e ndryshme të jashtëzakonshme.

Neni 144

1. Oda disponon me mjetet në pajtim me planin vjetor të cilin e miraton Kuvendi i Odës dhe në pajtim me Ligjin për Avokatinë dhe këtë Statut.

2. Oda mjetet mund t'i përdor për:

2.1 aktivitetet e rregullta të tyre;

2.2 blerjen/prokurimin e pasurisë dhe të drejtave sendore;

2.3 anëtarësi në organizatat ndërkombëtare;

2.4 të ardhurat personale të punësuarve në administratën e Odës;

2.5 ndihmë avokatëve dhe familjeve të tyre, si dhe mënyrën e grumbullimit të mjeteve për ato destinime, rregullohet me akt të veçantë nënligjor të Odës;

2.6 kompensime anëtarëve të komisioneve dhe të trupave punues;

2.7 botimin e publikimeve dhe të botimeve tjera;

2.8 punimin e shpërblimeve, njohjeve dhe të materialit reklamues;

2.9 qëllime humanitare;

2.10 qëllime tjera në pajtim me ligjin, Statut dhe aktet tjera normative.

Neni 145

1. Vepimtaria financiare i nënshtrohet auditimit të brendshëm se paku një (1) herë në vit dhe auditimit të jashtëm të pavarur çdo vit kalendarik.
2. Bilancin mbi afarizmin financiar e miraton Kuvendi i Odës.
3. Bilancin e nënshkruan Kryetari i Odës.

XVII. SHENJA DHE VULAT E ODËS.

Neni 146

Oda e ka shenjën e vet të cilën e përcakton Kuvendi.

Neni 147

Vulat e Odës janë në formë të rrumbullakët dhe në formë katrori me mbishkrimin: Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosova, ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS/ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA/KOSOVA BAR ASSOCIATION. Vula katrore përmban edhe shenjën e protokollit “Nr. Br. No. _____” dhe “ Dt. _____”.

Neni 148

Përmbajtja e vulave tjera për nevojat e Odës përcaktohet me vendim të veçantë të Këshillit Drejtues të Odës.

Neni 149

1. Ngjyrat zyrtare në të cilat mund të shtypën vulat janë:
 - 1.1 e zezë dhe
 - 1.2 kaltër e mbylltë.

XVIII. ADMINISTRATA E ODËS

Neni 150

1. Për ushtrimin e aktivitetit të vet, Oda rekruton stafin.
2. Stafi i Odës udhëhiqet dhe mbikëqyret nga Drejtori Ekzekutiv.

Neni 151

Të drejtat dhe detyrimet e stafit administrativ të Odës përcaktohen me rregullore të veçantë.

Neni 152

1. Themelimi i vendit të punës në Odë bëhet me vendimin e Këshillit Drejtues i Odës.
2. Marrëdhënien e punës, punëtorët e themelojnë në bazë të kontratës së punës dhe dispozitave të tjera të parapara në Ligjin e Punës.

XIX. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 153

1. Oda do t'i harmonizojë aktet e tjera të përgjithshme me këtë Statut të Odës në afat prej nëntë (9) muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Statuti.
2. Deri në nxjerrjen e akteve tjera të përgjithshme nga paragrafi 1 i këtij neni do të zbatohen aktet e përgjithshme në fuqi të cilat nuk janë në kundërshtim me këtë Statut.
3. Kërkesat për regjistrim në Regjistrin e avokatëve të Odës dhe në regjistrat e tjerë të Odës të cilat janë paraqitur para hyrjes në fuqi të këtij Statuti dhe nuk janë vendosur deri në hyrjen në fuqi të tij, do të vendosen në bazë të këtij Statuti dhe të akteve të përgjithshme të Odës të cilat janë nxjerrë në bazë të këtij Statuti, nëse kjo është e njëjtë ose më e përshtatshme për paraqitësin e kërkesës.
4. Procedura disiplinore që është zhvilluar para hyrjes në fuqi të këtij Statuti dhe nuk është përfunduar deri në hyrjen në fuqi të tij do të zbatohet në bazë të këtij Statuti dhe të akteve të përgjithshme të Odës që janë nxjerrë në bazë të këtij Statuti, nëse është e njëjtë ose më e përshtatshme për personin për të cilin është ngritë procedura disiplinore.

Neni 154

1. Organet e Odës, të zgjedhura sipas dispozitave të Statutit që ka qenë në fuqi para hyrjes në fuqi të këtij Statuti, e vazhdojnë punën sipas mandatit të përcaktuar me këtë Statut.
2. Shtetasi i shtetit anëtarë të Bashkimit Evropian mund të regjistrohet në regjistrin e avokatëve në pajtim me nenin 46 par. 2 i këtij Statuti prej ditës integrimit të Republikës së Kosovës në Bashkësinë Evropiane.
3. Dispozitat e nenit 46 deri 55 të këtij Statuti, do të zbatohen nga dita e hyrjes së Republikës së Kosovës në Bashkësinë Evropiane.

Neni 155

Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti të Odës pushon të vlejë Statuti ekzistues i Odës me anekset mbi ndryshimet dhe plotësimet e tij dhe Rregullorja për licencimin e avokatëve të huaj e nxjerrë nga Oda më 29 tetor 2011.

Kryetari i OAK-së
Av. Osman Havolli